

V E N D I M
Nr.194, datë 22.4.1999

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE MËSIMORË, NË
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

I azhurnuar me:

- VKM Nr.617, datë 21.12.1999
- VKM Nr.377, datë 14.07.2000
- VKM Nr.596, datë 13.11.2000
- VKM Nr.426, datë 11.06.2001
- VKM Nr.463, datë 12.07.2001
- VKM Nr.298, datë 27.06.2002
- VKM Nr.639, datë 18.09.2003
- VKM Nr.863, datë 17.12.2004
- VKM Nr.230, datë 19.04.2006
- VKM Nr.357, datë 14.06.2006
- VKM Nr.440, datë 13.07.2007
- VKM Nr.865, datë 12.12.2007
- VKM Nr.1095, datë 02.07.2008

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr.7583, datë 13.7.1992 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për punonjësit mësimorë, në arsimin parashkollor, arsimin 8-vjeçar, arsimin e mesëm, bazat prodhuese në shkollat teknike profesionale, konviktet e këtyre shkollave dhe në qendrat kulturore të fëmijëve, skema e strukturës së pagës është sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Struktura e pagës mujore përbëhet:

I. Pagat e grupit, sipas nivelit arsimor, të kërkuar nga vendi i punës:

- Paga e grupit II “2”

Me shkollë të mesme pedagogjike;

Me shkollë të mesme profesionale, ku fitohet specialiteti për mësuesi;

Diplomë mbi shkollën e mesme.

Diploma mbi shkollën e mesme janë të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Në këtë grup përfshihen, gjithashtu, të gjithë ata, të cilët kanë mbaruar 2 vite akademike të shkollës së lartë.

Pagat për çdo grup pune janë sipas lidhjes nr.2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shtesa për vjetërsi pune, jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

III. Shtesë kualifikimi. Kjo shtesë jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet

mbi pagën e grupit, në përqindje, si vijon:

- Në masën 5 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së tretë;
- Në masën 10 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së dytë;
- Në masën 20 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së parë.

IV. Shtesa e pozicionit është e përcaktuar për çdo vend pune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Mësuesit, që punojnë larg vendbanimit, marrin një shpërblim mujor sipas lidhjes nr.3, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3/1. Mësuesit e matematikës, fizikës dhe të informatikës në shkollat e mesme dhe mësuesit e matematikës dhe fizikës në shkollat 8-vjeçare, me diplomë universitare në degët matematikë, fizikë dhe informatikë, përfitojnë një shtesë për kushte pune, në masën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë në muaj.

4. Punonjësit e jashtëm, inxhinierë, agronomë, ekonomistë, etj., që japin mësim në shkollat e mesme dhe në shkollat teknike e profesionale, për çdo orë mësimi paguhen me 145 (njëqindedyzetepesë) lekë.

Punonjësit mësimorë, që për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën mësimore, të lejuar me dispozita, paguhen për çdo orë mësimore si vijon:

- në shkollat e mesme.....145 (njëqindedyzetepesë) lekë;
- në shkollat 8-vjeçare.....120 (njëqindinjëzet) lekë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

6. Efektet ekonomike, për zbatimin e këtij vendimi, janë parashikuar në buxhetin e vitit 1999.

7. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992, “Për pagat e punonjësve në institucionet buxhetore”, bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 7, pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Punonjësit, që i kanë përfituar këto shtesa, do të vazhdojnë t’i përfitojnë ato, derisa të qëndrojnë në këtë vend pune. Punonjësit, që fillojnë punë për herë të parë në arsim, nuk i përfitojnë ato. Për raste të veçanta, Këshilli i Ministrave miraton shtesa, të cilat nuk përfshihen në pagë.”.

- Pika 10 nuk zbatohet për mësuesit.

8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.136, datë 25.3.1994, “Për shtesën në pagë për vështirësi shërbimi të punonjësve, që punojnë drejtpërdrejtë me fëmijët dhe nxënësit, në sistemin e arsimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 maj 1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIDHJA NR.1
STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE	
		PAGA INDIVIDUALE	SHTESA E POZICIONI

					T
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
		1	2	3	4
1	Drejtor i shkollës së mesme, Përgjegjës poligoni, Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë, Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë, Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore, Drejtor i konvikteve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	40 000
2	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme, Përgjegjës i bazës prodhuese, Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë, Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë, Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme të larta mendore, Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	35 000
3	Drejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	31 500
4	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV-ërt, Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive, Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare, Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	29 500
5	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	28 500
6	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	26 500
7	Mësues në shkollat e mesme, Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë, Mësues në institutin e nxënësve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	28 500

	që nuk dëgjojnë, Mësues në shkollat me probleme të larta mendore, Inspektor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve				
8	Mësues në shkollat 9-vjeçare, klasa I-IX. Edukator konvikti, Kujdestar konvikti	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	25 600
9	Edukator në kopësht fëmijësh	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	23 000
10	Mësues	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	21 000
11	Mësues	3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	21 000
12	Edukator në kopësht fëmijësh	3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	19 300
13	Edukator në kopësht fëmijësh	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	19300

LIDHJA NR.2
VLERA E PAGËS SË GRUPIT SIPAS NIVELIT ARSIMOR

GRUPI	PAGA NË LEKË
1	11 000
2	9 000
3	7 500
4	4 700

LIDHJA NR.3
SHPËRBLIMI MUJOR PËR PUNONJËSIT MËSIMORË NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR, QË PUNOJNË LARG VENDBANIMIT

Mësuesit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin shpërblim si vijon:

- Kur punojnë brenda rrethit të tyre por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 1500 (një mijë e pesë qind) lekë në muaj, kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 4375 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre, në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë deri në 5875 (pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj kur punojnë në qytet dhe në qendër të rrethit, dhe deri në 7250 (shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit, në rrethet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd deri në 4375 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj kur punojnë në qytet dhe në qendër të rrethit, dhe deri në 5875 (pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet e tjera, deri në 3000 (tre mijë) lekë në muaj, kur punojnë në qytet dhe në qendër të rrethit, dhe deri në 4375 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.